



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE
INDUSTRIË**

Nr. 2642/prot.
1

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.894/1, datë 12.02.2016.

**SHOQËRISË “ LOTI” SH.P.K
Nikël, Fushë Krujë, Bashkia Krujë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “ LOTI ” sh.p.k, është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit, sipas Akt – Miratimit nr.894/1, datë 12.02.2016, shtyrje afati 10 vjeçar e lejes minerare 894, datë 03.08.2005, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “ Makaresh”, Bashkia Krujë, Qarku Durrës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.1668/1 prot, datë 28.02.2019 protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.2603 prot, datë 28.02.2019 dhe nr.1830 prot, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.2642 prot, datë 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.894/1, datë 12.02.2016, për mineralin gur gëlqeror, në objektin “ Makaresh ”, Krujë. për arsye se, gjatë kontrollit në objekt u evidentua se;

- Në zhvillimin e aktivitetit minerar nuk janë ruajtur parametrat teknikë të shkallëve të karrierës dhe pjerresisë së shpateve të tyre, sipas projektit të miratuar në Këshillin Teknik pranë AKBN- së dhe si rrjedhojë nuk ka respektuar Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010. “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Neni 47, pika 1, shkronja “ dh”.
- Në Akt –miratimin Nr.894/1, dt 12.02.2016, të Lejes Minerare të Shfrytëzimit, është planifikuar që gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të realizohet prodhimi vjetor i mineralit 10000m³. ndërkohë që për vitin 2018, keni deklaruar prodhimin 7807m³ gurë gëlqeror, duke mos plotësuar detyrimin ligjor, sipas programit të miratuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore

për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar .

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010. “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.894/1, datë 12.02.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Duhet te paguani si difference rehabilitimi shumen 194019 leke, pasi nga 325977 lekë që duhet te kishit paguar sipas sipërfaqes se prekur nga shfrytëzimi, keni paguar 131958 leke.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.894/1, datë 12.02.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

